

**Periodiku AMF**

AMF zhvillon aktivitetet: mbi “Prezantimin e sistemit të ri të raportimit elektronik të mbikëqyrjes, AMF In-Reg”, “Liberalizimin e MTPL, mundësitë dhe sfidat”, si dhe aktivitetin mbi promovimin e Ligjit të ri “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, zhvilloi në datat 17, 18 dhe 20 nëntor 2009, në ambientet e hotel “Rogner Europapark” aktivitetet mbi “Prezantimin e sistemit të ri të raportimit elektronik të mbikëqyrjes, AMF In-Reg”, “Liberalizimin e MTPL, mundësitë dhe sfidat”, si dhe aktivitetin mbi promovimin e Ligjit të ri “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”.

Vijon në faqen 2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura**Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-tetor 2009**

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-tetor arritën shifrën 6,684,806 mijë lekë përkundrejt 5,977,989 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2008 ose 11.82% më shumë.

Vijon në faqen 4

Ngjarje dhe zhvillime të tjera**Zhvillohet konferenca vjetore e komitetit të tregjeve në zhvillim**

Gjatë periudhës 4-6 nëntor 2009, në Bukuresht, u zhvillua konferenca vjetore e komitetit të tregjeve në zhvillim. IOSCO është institucioni që vendos standardet botërore për rregullimin e tregjeve të kapitaleve dhe forumi i parë botëror për bashkëpunimin ndërmjet rregullatorëve.

Vijon në faqen 7

Zhvillohet seminari ndërkombëtar i FSA-së 2009, Angli

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (FSA), Londër, zhvilloi gjatë periudhës

30 nëntor-3 dhjetor 2009 seminarin ndërkombëtar 2009.

Vijon në faqen 8

Zhvillohen takime mbi përdorimin e IFRS-ve për qëllime të kujdesshme për rregullatorët

Qendra për reformat financiare e Bankës Botërore, në bashkëpunim me Organizatën Austriake për Zhvillim (Austria Development Cooperation), në kuadër të projektit REPARIS Road to Europe: programi i llogaritjes së reformave dhe fuqizimit institucional (Program of Accounting Reform and Institutional Strengthening), zhvilluan në datat 31 tetor-3 nëntor, në Vjenë seminare të cilët u përmyllën me një konferencë ministrore.

Vijon në faqen 9

Zhvillohet konferenca vjetore mbi përshtatjen e ekonomisë në rrjetin e investimeve të mjedisit social dhe qeverisë në Evropë e Azi

Në datat 12-13 nëntor 2009, në Amsterdam, Holandë u zhvillua Konferenca Vjetore mbi përshtatjen e ekonomisë në rrjetin e investimeve të mjedisit social dhe qeverisë në Evropë e Azi.

Vijon në faqen 10

Edukimi i konsumatorit**Prezantim i Industrisë së Sigurimeve, botim i Rodney Lester**

(Material i nxjerrë nga faqja e Bankës Botërore, mars 2009)

Sigurimet dhe zhvillimi

Në të vërtetë nuk ka pasur kërkime akademike mbi rolin ekonomik të sigurimeve: vlerësimet mbi riskun mungojnë në shumicën e kurseve akademike të ekonomisë. Gjithsesi, një organizëm kërkimor, i mbështetur shumë nga Banka Botërore dhe Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), është tashmë duke dalë me opinionin i cili paraqet një rritje të shkaqeve që shkakton zhvillimi i sektorit të sigurimeve tek zhvillimi ekonomik.

Vijon në faqen 10

Në këtë numër:

AMF zhvillon aktivitetet: mbi “Prezantimin e sistemit të ri të raportimit elektronik të mbikëqyrjes, AMF In-Reg”, “Liberalizimin e MTPL, mundësitë dhe sfidat”, si dhe aktivitetin mbi promovimin e Ligjit të ri “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

4

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

7

Edukimi i konsumatorit

10

AMF zhvillon aktivitetet: mbi “Prezantimin e sistemit të ri të raportimit elektronik të mbikëqyrjes, AMF In-Reg”, “Liberalizimin e MTPL, mundësitë dhe sfidat”, si dhe aktivitetin mbi promovimin e Ligjit të ri “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”

“Prezantimi i sistemit të ri të raportimit elektronik të mbikëqyrjes, AMF In-Reg”



Gjatë zhvillimit të aktivitetit mbi “Prezantimin e sistemit të ri të raportimit elektronik të mbikëqyrjes, AMF In-Reg”

Sistemi **AMF In-Reg**, një platformë raportimi me bazë Web-i, po ndërtohet nga AMF mbështetur nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe financuar nga Fondi i Ballkanit Perëndimor. Ky sistem do të përdoret për grumbullimin e të dhënave dhe më tej përpunimin e tyre, me synim gjenerimin e raporteve dhe evidentimin në kohë të problemeve. Zbatimi i platformës elektronike të raportimit dhe analizës, synon monitorimin nga afër të gjendjes financiare dhe aftësisë paguese të operatorëve në treg



Kryetarja e AMF-së, Zj. Elisabeta GJONI

Kryetarja e AMF-së Zj. Elisabeta Gjoni, prezantoi vizionin e mbikëqyrjes efektive, projektet në proces të AMF-së për rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes, si dhe rëndësinë dhe avantazhet e sistemit të ri të raportimit AMF In-Reg.

Në vijim, Drejtori Përgjithshëm i Grupit Vizor, Z. Martin Murnaghan, prezantoi produktin In-Reg, ndërsa Zj. Alma Qamo, Këshilltare në AMF, prezantoi bashkësinë e formave e axhendën paraprake të zbatimit në bashkëpunim me tregun.

Gjatë takimit u demonstrua funksionimi i platformës elektronike të raportimit, nga Z. Matt Cusack, Drejtues i Projektit Vizor, i cili në detaje tregoi funksionimin e programit dhe elementeve përbërës të tij. Paketa e re e raportimit ka

realizuar edhe përputhshmërinë me standardet SNRF, të cilat janë në fuqi në Shqipëri që nga fundi i vitit 2008. Infrastruktura garanton siguri, besueshmëri dhe konfidencialitet në transmetimin dhe mbajtjen e informacionit.

Fillimisht, platforma do të fokusohet tek shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensioneve dhe në një të ardhme të afërt ajo do të zgjerohet pa kërkuar modifikime të mëdha edhe për mbikëqyrjen e tregut të letrave me vlerë në Shqipëri.

“Liberalizimi i MTPL, mundësitë dhe sfidat”



Gjatë zhvillimit të aktivitetit mbi “Liberalizimin e MTPL, mundësitë dhe sfidat”

Qëllimi i aktivitetit mbi “*Liberalizimin e MTPL, mundësitë dhe sfidat*”, ishte komunikimi me tregun e sigurimeve, për të diskutuar dhe analizuar skenarët e mundshëm që duhet të shoqërojnë një proces drejt liberalizimit të këtij tregu.

Kryetarja e AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, prezantoi situatën aktuale në Shqipëri, si dhe strategjinë dhe politikat e AMF-së drejt liberalizimit të MTPL, në përputhje me direktivat evropiane.

Nisur nga pesha dhe rëndësia që MTPL ka në tregun shqiptar, sikurse dhe në shumë vende në zhvillim, rruga drejt liberalizimit të tarifave kalon

nëpërmjet një sërë sfidash, kapërcimi i të cilave kërkon midis të tjerave një komunikim efikas midis Rregullatorit dhe tregut.

Në vijim, ekspertja e Bankës Botërore, Zj. Serap Gonulal, prezantoi dhe një punim të Bankës Botërore, punim i cili sjell eksperiencë interesante për sigurimin MTPL në vendet në zhvillim, ndërsa Z. Sergio Desantis, aktuar në sigurimin e jo-jetës, prezantoi situatën e MTPL në juridiksione të ndryshme, në parantezë me mundësitë dhe sfidat që karakterizojnë vendet e zhvilluara.

Temat e trajtuara u ndoqën me mjaft interes dhe



pati mjaft diskutime nga Drejtorët e Përgjithshëm të Shoqërive të Sigurimit dhe drejtues të tyre në sektorët e financës, aktuaristikës, etj.

Komunikimi me tregun do të ndihmojë në ndjekjen e praktikave më të mira, që duhet të shoqërojnë procesin e liberalizimit, midis të tjerave: afatet kohore, reagimet e aktorëve të tregut si dhe parashikimi i efekteve të mundshme tek tarifat dhe për rrjedhojë në aftësinë paguese.

Promovimi i Ligjit nr. 10158, datë 15.10.2009 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”



Gjatë zhvillimit të takimit mbi Ligjin e ri “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”

Gjatë zhvillimit të aktivitetit mbi promovimin e Ligjit nr. 10158, datë 15.10.2009 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”, Kryetarja e AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, bëri një prezantim lidhur me rrugën drejt zhvillimit dhe risive që do sjellë ky ligj në fushën e tregut të titujve. Qëllimi i miratimit të Ligjit të ri “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”, është përmirësimi i bazës ligjore dhe zhvillimi i tregut të kapitaleve, në kuadër të ndryshimeve që pësoi legjislacioni shqiptar me ligjin publik financiar dhe tregtar, veçanërisht pas aprovimit të Ligjit “Për Titujt” dhe Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Në vijim u bënë prezantime nga, Drejtori i Përgjithshëm i BERZH-it, Z. Daniel Berg i cili theksoi se: “Miratimi i këtij ligji është një hap i rëndësishëm, por ne duhet të punojmë për zbatimin e tij. Përfaqësuesit kryesorë në tregun e kapitaleve duhet të kryejnë hapat e tyre në mënyrë që ta kthejnë këtë ligj në një mjet të rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë.”. Më tej, konsulenti Z. Dimitris Tsibanoulis, bëri një prezantim të plotë të ligjit e Zj. Argyro Leoutsea, Z. Theodor Latsas vazhduan me prezantimet e tyre gjithashtu ne lidhje me

permbajtjen dhe pjesë të veçanta të ligjit. Z. Joan Canaj, përfaqësues pranë Raiffeisen Bank, diskutoi në lidhje me situatën e aktuale në tregun shqiptar



të obligacioneve.

Struktura e ligjit aktual është në gjendje të lejojë me lehtësi modernizimin e mundshëm të tregut, duke përfshirë dispozita për tipe të reja të huave të obligacioneve, sipas tendencave ndërkombëtare dhe kërkesave të tregut vendor. Ky ligj do të mundësojë krijimin e një tregu obligacionesh në vendin tonë, treg i cili është i nevojshëm për t'u dhënë mundësi shoqërive aksionare dhe njësisë të qeverisjes vendore që të rrisin nivelin e huasë, në kushtet kur sektori bankar nuk ka mundësi të mbështesë më tej me kredi bankare. Funksionimi i këtij tregu do të ndikojë në zgjerimin e tregjeve financiare që veprojnë në vendin tonë, si dhe rritjen e kapitalit dhe të investimeve në ekonomi.

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-tetor 2009

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-tetor arritën

shifrën 6,684,806 mijë lekë përkundrejt 5,977,989 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2008 ose 11.82% më shumë.


Vihet re një ndryshim i strukturës së tregut të sigurimeve në favor të sigurimeve vullnetare. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 46.44% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 53.56% të tregut, ku në krahasim me vitet e mëparshme primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zinin pjesën më të konsiderueshme të tregut. Përsa i takon rritjes

së tregjeve në veçanti, kemi një rritje në masën 38.92% të sigurimeve të jetës dhe 9.74% të sigurimeve të jo-jetës.

Megjithë rritjen që shënuan sigurimet e jetës, sërish 91.12% e primeve u gjenerua nga sigurimet e jo-jetës.

Gjatë 10-mujorit të 2009 u nënshkruan rreth 641,513 kontrata sigurimi, ose rreth 12.33 % më shumë se në njëjtën periudhë të vitit 2008.


Struktura e tregut të sigurimeve, janar - tetor 2009



Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto, janar - tetor (2008 - 2009)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
Periudha janar-tetor	2008	2009
A) Sigurimi i Jetës	427,283	593,577
B) Sigurimi i Jo - Jetës	5,550,706	6,091,229
Nga këto		
a) Sigurimi i Detyrueshëm	3,349,638	3,580,647
b) Sigurimi Vullnetar	2,201,068	2,510,582
TOTAL	5,977,989	6,684,806

Volumi i primit të shkruar bruto,
janar - tetor 2009 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Sigurimet e detyrueshme

Gjatë periudhës janar-tetor 2009, sigurimet e detyrueshme motorike vazhduan të dominojnë strukturën e tregut, duke sjellë 53.56% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme, për 10-mujorin 2009, arritën 2,292,930 mijë lekë, ose 0.02% më pak se në periudhën janar-tetor 2008.

Në janar-tetor 2009, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 952,633 mijë lekë, ose rreth 21.55% më shumë se në periudhën janar-tetor 2008.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë 10-mujorit 2009 arritën në 335,083 mijë lekë, apo 22.94% më shumë se në periudhën janar-tetor 2008.

Sigurimet vullnetare

Në periudhën janar-tetor 2009, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 3,104,159 mijë lekë, ose 18.10% më shumë se të ardhurat e

të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të jo-jetës, me të ardhura 2,510,582 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 27.87%, të pasuara këto nga siguri kasko me 20.77% dhe siguri i përgjegjësisë të përgjithshme civile me 18.70%. Peshë më të ulët patën siguri i aksidenteve dhe shëndetit, si dhe sigurimet e garancisë.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit në janar-tetor 2009 arritën në 321,675 mijë lekë, ose 30.92% më shumë se në periudhën janar-tetor 2008. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 77.68% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e jetës në 10-mujorin e vitit 2009 arritën në rreth 593,577 mijë lekë, ose rreth 38.92% më të larta se në po të njëjtën periudhë të vitin 2008. Rritja në sigurimet e jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të jetës për efekt kredie.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit


Tregu shqiptar i sigurimeve të jo-jetës ndahet ndërmjet kompanive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interbalkan, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 30.83% të primeve.

Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 54.19% të primeve.


Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë

Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, janar-tetor 2009 (Jo-Jeta)



Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, janar-tetor 2009 (Jeta)



e sigurimeve në janar-tetor 2009 kapi vlerën 1,386,636 mijë lekë, ose 10.08% më shumë se në janar-tetor të vitit 2008. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimeve motorike me 1,212,578 mijë lekë, apo 87.45 % të totalit. Në portofolin “Kartoni Jeshil” kemi një ulje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me 10.76% dhe rritje të numrit të dëmeve të paguara me 7.00%, krahasuar me periudhën janar-tetor të vitit 2008.

Risigurime

Gjatë periudhës janar-tetor 2009 primet nga risigurimi i pranuar kapën vlerën mbi 72,059 mijë lekë, të cilat i përkasin portofoleve “Aksidente Personale” dhe “Kasko”.

Zhvillohet konferenca vjetore e komitetit të tregjeve në zhvillim

Gjatë periudhës 4-6 nëntor 2009, në Bukuresht, u zhvillua konferenca vjetore e komitetit të tregjeve në zhvillim. IOSCO është institucioni që vendos standardet botërore për rregullimin e tregjeve të kapitaleve dhe forumi i parë botëror për

bashkëpunimin ndërmjet rregullatorëve. Ky takim i rëndësishëm mbledhi së bashku përfaqësues të autoriteteve mbikëqyrëse të tregut të letrave me vlerë nga vendet në zhvillim.

Këtë vit çështja kryesore e konferencës i'u dedikua



Gjatë zhvillimit të konferencës vjetore të tregjeve në zhvillim

krizës financiare me fokus në nevojën për të arritur një kuptim të përbashkët, se çfarë shkoi keq dhe gjithashtu për të përcaktuar nevojat për reforma thelbësore në këtë fushë.

Konferenca zhvilloi katër panele publike mjaft të rëndësishme.

Paneli i parë - u fokusua në arkitekturën e rregullatorëve të tregut financiar pas krizës dhe në masat që duhet të ndërmerren nga rregullatorët për t'u përballur me krizën. Diskutimet u përqendruan në iniciativën për një arkitekturë të re financiare në vendet e Bashkimit Evropian, karakteristikat e këtij sistemi, si dhe mundësinë e përshtatjes së tij me modelet ekzistuese të rregullatorëve.

Paneli i dytë - prezantoi pikëpamjet e ndryshme të autoriteteve mbikëqyrëse mbi rregullimin e tregjeve OTC.

Paneli i tretë - u fokusua në menaxhimin e krizës në tregjet në zhvillim, u mor me evidentimin e karakteristikave të tregjeve në zhvillim gjatë krizës financiare, nevojën e përdorimit të mekanizmave kombëtare e ndërkombëtare për bashkëpunim gjatë krizës.

Paneli i katërt - diskutoi mbi çështjet e kontabilitetit në kontekstin e krizës. Ky panel prezantoi pikëpamjet për pritshmërinë lidhur me modifikimin e IAS 39 dhe çështjen e instrumenteve financiarë, si një zgjidhje e kontabilitetit në përgjigje të krizës.

Diskutimet u përqendruan në vazhdimin e punës së IASB për finalizimin në fund të vitit që do të afektojë gjendjet financiare të vitit 2009. Një çështje me rëndësi që u diskutua nga pjesëmarrësit, ishte dhe ngritja e një task force e cila do të rishikojë drejtimin strategjik të rolit të IOSCO-s, si dhe qëllimet për vitet 2010-2015.

Për pesë vitet e ardhshme objektivat e IOSCO-s do të jenë:

- Të mbajë dhe përmirësojë kuadrin ligjor për tregjet e letrave me vlerë nëpërmjet vendosjes së standardeve ndërkombëtare;
- Të identifikojë dhe të adresojë riskun sistematik për funksionimin e drejtë dhe

efiçent të tregjeve;

- Të forcojë rolin e IOSCO-s brenda komunitetit financiar ndërkombëtar në mënyrë që të zbatojë objektiva dhe parime të nivelit të lartë.

Roli i Autoriteti të Mbikëqyrjes Financiare, mbetet ndjekja me vëmendje e të gjithë zhvillimeve të reja në këtë fushë dhe përshtatja sipas kërkesave të reja të BE-së.

Zhvillohet seminari ndërkombëtar i FSA-së 2009, Angli

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (FSA), Londër, zhvilloi gjatë periudhës 30 nëntor-3 dhjetor 2009 seminarin ndërkombëtar 2009.

Gjatë seminarit u theksua, se aktualisht jemi në vitin e tretë të një krize ekonomike-financiare dhe se debati vijon në atë që çfarë duhet të bëjmë ndryshe. FSA angleze prezantoi një rrugë të re që kishte të bënte me atë që u quajt mbikëqyrje intensive e që kishte të bënte me njerëzit, proceset dhe rezultatin.

Çështjet kryesore për diskutim u mbuluan nga një numër prezantimesh të mbajtura nga ekspertë të nivelit të lartë të FSA. Prezantimet kishin të bënin kryesisht me stabilitetin financiar, forcimin e standardeve të likuiditetit, menaxhimin e riskut, modelet e biznesit të sigurimeve, mbikëqyrjen praktike, modelet e brendshme të biznesit të sigurimeve, etj.

Në seminar u prezantua ideja e mbikëqyrjes intensive. Në të kaluarën, FSA ndërhynte vetëm kur kishte fakte lehtësisht të observueshme dhe mbështeste pikëpamjen se i duhet lënë menaxhimit të shoqërisë që të marrë vendimet e saj. Ndërsa, mbikëqyrja intensive fokusohet

në filozofinë, se mbikëqyrësit duhet të gjykojnë kompanitë mbi pasojat që mund të kenë vendimet e tyre, pra ‘të gjykosin mbi gjykimet’. Kjo do të thotë se proporcioni i kohës që shpenzonte FSA për rishikimin e sistemeve dhe kontrollit do të ulet duke u fokusuar në vlerësimin e rezultateve të veprimeve të kompanisë. Me qëllim që të arrihej testimi i këtyre rezultateve, kërkohej aftësi modelimi si p.sh për kapitalin dhe likuiditetin. Kjo sigurisht kërkonte shumë të dhëna që të mbledheshin nga kompanitë, si dhe të vlerësoheshin më mirë risqet.

Suksesi i kësaj metodologjie qëndron kryesisht në atë që mbikëqyrësi ka një këndvështrim të integruar mbi riskun e kompanisë.

Zhvillimet e fundit në metodologjinë e mbikëqyrjes kërkuar një platformë të re operacionale, gjë që ishte zbatuar nëpërmjet një programi të zhvillimit të mbikëqyrjes. Kjo kishte përfunduar në gusht 2009 dhe kishte përfshirë në vetvete: rekrutimin e mbi 280 specialistëve të rinj dhe stafi mbikëqyrjeje, zbatimin e një regjimi trajnimit të ri mbikëqyrjeje, prezantimin e një procesi të ri të identifikimit të riskut, etj

Në këtë seminar merrnin pjesë përfaqësues nga autoritete të ndryshme rregullatore.

Zhvillohen takime mbi përdorimin e IFRS-ve për qëllime të kujdesshme për rregullatorët

Qendra për reformat financiare e Bankës Botërore, në bashkëpunim me Organizatën Austriake për Zhvillim (Austria Development Cooperation), në kuadër të projektit REPARIS Road to Europe: programi i llogaritjes së reformave dhe fuqizimit institucional (Program of Accounting Reform and Institutional Strengthening), zhvilluan në datat

31 tetor-3 nëntor, në Vjenë seminare të cilët u përmyllën me një konferencë ministrore.

Aktiviteti u fokusua në fusha të rëndësishme si: raportimi financiar, mbikëqyrja e auditit, zbatimi i IFRS-ve në këto vende, matja e vlerës së drejtë, provigjonimi i humbjeve, filtrat e kujdesshëm për rregullatorët, si dhe SNRF për sigurimet.

Vlen të përmendet, që me përjashtim të Moldavisë, të gjitha vendet e tjera pjesëmarrëse në seminar kanë adoptuar tashmë SNRF. Dallimi qëndron vetëm në shtrirjen e fushës së aplikimit (për të gjitha bizneset pa përjashtim apo vetëm për njësitë me interes publik - PIE). Gjithashtu, në lidhje me mbikëqyrjen e auditit, pjesa më e madhe e vendeve nuk kanë akoma një strukturë kombëtare mbikëqyrëse të auditit. Edhe në ato vende ku kjo strukturë është ngritur, është e re dhe jo shumë funksionale.

Në trajtimin e IFRS-ve, theksi u vu në sfidat për rishikimin e IAS 39 në lidhje me klasifikimin dhe matjen (mbi të cilin tashmë ka dalë standardi), amortizimi me kosto (pritet në qershor 2010), si dhe kontabiliteti i hedging (pritet në dhjetor 2009). Filtrat e kujdesshëm për qëllime rregullatore ishin një çështje tjetër shumë e rëndësishme që u diskutua. Theksi u vu në zbatimin që ka pasur adoptimi i SNRF në llogaritjen e kapitalit për qëllime rregullatore. Sipas komenteve të pjesëmarrësve, pothuajse të gjithë përdorin filtra shtesë, përveç atyre të nënkuptuara nga SNRF-të.

Në lidhje me SNRF për sigurimet theksi kryesor u vu në sfidat që lidhen me matjen e kontratave të sigurimit dhe të vlerës së tashme të flukseve të ardhshme. Matja e detyrimeve dhe supozimet që qëndrojnë në bazën e kësaj matjeje përbën përsëri një element shumë të rëndësishëm nën këndvështrimin rregullator.

Çështjet kryesore që dolën nga këto aktivitete dhe që njëkohësisht u lanë si çështje për t'u thelluar dhe fokusuar më shumë në të ardhmen ishin:

- Nevoja për trajnime në fushën e aplikimit të SNRF (ngritjen e kapaciteteve njerëzore) sidomos në lidhje me SNFR për bizneset e vogla për të cilën ka shumë pak informacion.
- Nevoja për një përditësim sa më real dhe në kohë me ndryshimet në SNRF, e rëndësishme sidomos për rregullatorët.

Në përfundim të këtij aktiviteti, më datën 3 dhjetor, u mbajt një konferencë ministrore ku merrnin pjesë përfaqësues (ministra, zv/ministra të financave) të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Konferenca u fokusua në çështje që lidhen me stabilitetin financiar, si dhe ndikimin e raportimit financiar. Gjithashtu në konferencë u theksua përvoja e mirë e krijuar tashmë nga projekti REPARIS. Ministrat e vendeve pjesëmarrëse dhanë nga një pasqyrë të hapave të ndërmarrë nga këto vende, në drejtim të një stabiliteti më të madh financiar, si dhe të tregjeve financiare më të mirë informuara me qëllim final integrimi Evropian.

Në këto aktivitete morën pjesë përfaqësues nga vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilët aspirojnë për integrim në EU.

Zhvillohet konferenca vjetore mbi përshtatjen e ekonomisë në rrjetin e investimeve të mjedisit social dhe qeverisës në Evropë e Azi

Në datat 12-13 nëntor 2009, në Amsterdam, Holandë u zhvillua Konferenca Vjetore mbi përshtatjen e ekonomisë në rrjetin e investimeve të mjedisit social dhe qeverisës në Evropë e Azi. Temat kryesore që u trajtuan në konferencë ishin:

- Investimi në përhapjen globale duke vendosur kapitalin në shkallë të tillë që të

prodhojë vlera sociale dhe mjedisore në vend të të ardhurave financiare;

- Ristrukturimi i shoqërive financiare në përputhje me ekonominë në një botë të krizave ekonomike;
- Përdorja e aksionarëve aktiv në shoqëri, në mënyrë që të kemi një performancë dhe të ardhura të kënaqshme;
- Debate të thelluara në lidhje me etikën, në kuptimin se sa institucionale dhe sa personale duhet të jenë këto norma etike në krahasim me ato ekzistuese, etj.

Konferenca ishte e ideuar në një numër të madh seminaresh dhe pjesëmarrja në disa prej tyre ishte me shumë interes.

Edukimi i konsumatorit

Prezantim i Industrisë së Sigurimeve, botim i Rodney Lester

(Material i nxjerrë nga faqja e Bankës Botërore, mars 2009)

Sigurimet dhe zhvillimi

Në të vërtetë nuk ka pasur kërkime akademike mbi rolin ekonomik të sigurimeve: vlerësimet mbi riskun mungojnë në shumicën e kurseve akademike të ekonomisë. Gjithsesi, një organizëm kërkimor, i mbështetur shumë nga Banka Botërore dhe Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), është tashmë duke dalë me opinionin i cili paraqet një rritje të shkaqeve që shkakton zhvillimi i sektorit të sigurimeve tek zhvillimi ekonomik. Këto shfaqen të aplikohen për sigurimin e jo-jetës në të gjitha fazat e zhvillimit (asnjë vend nuk mund të tregtojë pa u siguruar) dhe për sigurimin e jetës në fazat e mëvonshme të zhvillimit (Arena 2006). Kërkimi ka treguar rolin kryesor të sigurimeve në dhënien e mbështetjes së krijimit të kreditit dhe financave tregtare, si dhe në zhvillimin e tregjeve

të kapitalit dhe të borxhit afatgjatë (Impavido 2003). Kriza e fundit financiare gjithashtu nxori në pah mos besueshmërinë e dhënieve hua nga bankat (veçanërisht të dhënieve hua ndërmjet shteteve) nën presion dhe rëndësinë e zhvillimit të burimeve më të besueshme të financimit në afat gjatë. Si përfundim, tashmë është duke u bërë e qartë që tregjet me risk mund të luajnë një rol kryesor në mbrojtjen e vendeve në zhvillim nga tensionet fiskale dhe të likuiditetit të cilat pasojnë katastrofat e mëdha natyrore.

Ka shumë pak shembuj të falimentimit të sektorit të sigurimeve në kundërshtim me një ndikim sistematik në ekonomi. Në shumicën e rasteve, ku kjo ka ndodhur, ajo është krijuar nga lidhje me sektorin bankar: shkrirja Xhamajkane në fundin e viteve 90' është ndoshta shembulli më i mirë. Njihet vetëm një rast me një ndikim të drejtpërdrejtë në ekonomi. Ky ishte rasti i falimentimit të kompanisë HIH në Australi, e cila kërcënoi duke çuar industrinë e ndërtimit në një stopim nga mungesa e mbulimit të kërkuar me sigurim. Gjithsesi kjo u korrigjua në mënyrë të shpejtë. Në mënyrë të ngjashme, njihet një rast i kohëve të fundit i falimentimit të një kompanie sigurimi e ardhur në mënyrë thelbësore nga likuiditeti. Ky ishte rasti i Confederation Life në Kanada, e cila ishte duke i shteruar asetet e saj likuide nëpërmjet transferimit tek filialet e saj që merreshin me aktivitet leasingu dhe në pasuri të paluajtshme. Pjesa më e madhe e siguruesve falimentojnë për shkak të mos disponimit të aftësisë paguese, edhe pse shpesh reduktimet domethënëse të flukseve të parasë janë një sinjal që po lindin probleme për siguruesit e jo-jetës. Mikrosigurimet për shtresat e varfra dhe sektorët informalë janë akoma në një fazë fillestare zhvillimi por kanë një potencial të konsiderueshëm, si në sensin që lidhet me kreditimin nëpërmjet institucioneve

mikrofinanciare ashtu dhe për qëllime të qarta të sigurisë sociale nëpërmjet fondeve të investimit dhe organizatave të bazuara në komunitete.

Çështje të politikave në zhvillimin e tregut të sigurimeve

Struktura industriale dhe kapitali minimal

Një rregull i përgjithshëm i pranuar është që madhësia minimale e mostrës (në terma të numrit të dëmeve) për të prodhuar një prim të pastër për një qelizë të dhënë të klasifikimit (e cila është, një bashkësi kolektive e kënaqshme e karakteristikave të riskut, siç janë fuqia motorike e mjetit, mosha e drejtuesit të mjetit, dhe kështu me radhë) është 1,000. Duke supozuar një frekuencë dëmsh me 10%, që do të thotë që një qelizë klasifikimi ka nevojë për 10,000 policëmbajtës. Kështu që shumë sigurues në vendet në zhvillim, tranzicion dhe ato industriale janë shumë të vegjël për të qenë eficient në mënyrë statistikore. Ato janë në gjendje të funksionojnë sepse risigurimi është në gjendje të eliminojë rezultatet ekstreme potenciale të portofoleve të tyre të riskut. Në mënyrë thelbësore këta sigurues të vegjël janë “përcjellës” për risiguruesit ndërkombëtarë, ndërsa risiguruesit Evropianë në veçanti kanë një histori të gjatë në dhënien e mbështetjes teknike për krijimin e njësive të tilla.

Shkalla dhe qëllimi i funksionimit gjithashtu mund të jenë të rëndësishme, por studimet e kryera deri më sot tregojnë që ka një nivel optimal përtej të cilit kompleksiteti dhe mungesa e njohurive lokale filluan të reduktonin efikasitetin.

Nga një këndvështrim i mbikëqyrjes, një numër i madh i siguruesve janë të padëshirueshëm duke konsideruar burimet e kufizuara e të shpërndara nga qeveritë tek sektorët jo-bankarë dhe mundësinë e tejkalimit të konkurrencës, e krijuar nga një mosfunksionim i mekanizmave të sinjalizimit.

Disa juridiksione të rëndësishme (Nigeria dhe

Rusia janë shembujt më të fundit) kanë rritur kapitalin e kërkuar minimal për të forcuar konsolidimin e sektorëve tërësisht të fragmentuar dhe për të ndihmuar të zhvillohen shembuj lokalë. Disa vende të mëdha të hapur ndaj aktorëve të huaj (për shembull, Kina dhe India) kanë vendosur kërkesa shumë të larta për kapital fillestar për të filtruar pothuajse vetëm siguruesit më të mëdhenj ndërkombëtarë dhe për të mbështetur nevojat e mëdha për kapital fillestar. Tashmë është botërisht e kërkuar që sigurimi i jetës dhe jo-jetës duhet të kryhet nga kompani të licencuara në mënyrë të ndarë dhe si rregull kërkesat për kapital minimal janë më të mëdha për siguruesit e jetës (dhe për risiguruesit).

Sigurimet financiare

Sigurimet financiare përfshijnë linja të tilla si sigurimi i huave hipotekore, i cili në mënyrë tipike mbulon riskun e mospagimit në nivele të larta të raporteve LTV¹ - hua ndaj vlerës (veçanërisht nëse janë të krijuara tregje dytësore hipotekore), sigurime të garantimit të borxhit (i cili mbështet klasifikimet e kreditimit të borxhit), sigurimin e financave të projektit (të cilat mbulojnë projekte afatgjata të varura nga furnitori ose financimi i përdoruesit të fundit), sigurimin e kreditit të konsumit dhe sigurimin e përgjegjësisive ndaj mashtrimeve (ky sigurim mbulon sjelljet e pandershme të ekzekutivëve në kompani, që merren me transaksionet financiare dhe njihet ndryshe si sigurimi bankar BBB eng. bankers blanket bonds). Ajo çka mund të diskutohet është që, si risiguruesi, ashtu edhe siguruesit e kreditit janë qendra të ekspertizës së specializuar të marrjes në sigurim dhe menaxhimit të riskut, të afta për të mbështetur një gamë të gjerë iniciatorësh. Gjithsesi ajo çka gjithashtu duhet

të njihet është që risqet kanë paralelizma me

risigurimin e katastrofave duke qenë se ligji i numrave të mëdhenj tenton të mos jetë përkatës brenda një juridiksioni të caktuar, në të cilin sigurime të tilla janë vërtet të domosdoshme (që është, duke u krijuar nga disa kombinime të ngjarjeve sistematike siç janë normat e larta të interesit dhe papunësia e lartë). Në vendet industriale dhe disa prej tyre në tranzicion, në mënyrë të veçantë risqet e kreditit duhet të shkruhen nëpërmjet “siguruesve” të specializuar të ashtuquajtur linja të veçanta eng. monolines, me kapitalizime të mëdha të cilat reflektojnë raportet e humbjeve nga 400 deri 600%, të cilat ato mund t’i përjetojnë çdo dekadë ose më tej. Vendet të cilat kanë tashmë sigurues financiarë ose janë duke menduar për to këshilla normale është të kihet një pjesë të veçantë të specializuar në ligj, për të kërkuar që ato janë të ndara nga linjat e tjera të biznesit (në mënyrë të preferuar në njësi të ndara të licencuara) dhe janë të kapitalizuara në mënyrë të përshtatshme me risigurim të mjaftueshëm. Përveç nevojave të mëdha të diferencuara për kapital argumenti i veçimit të linjave të veçanta, rrotullohet rreth natyrës së tyre unike, efektivisht humbje të pakufizuara të ndërthurura me përfitime të kufizuara nga konkurrenca dhe rregullimi, si dhe mundësisht një lidhje e ngushtë me klasifikimin e instrumenteve të tregut të kapitalit. Në këto situata është thelbësore një strukturë e pastër dhe e aftë për të siguruar kapital në mënyrë të shpejtë dhe të jetë e vlerësueshme nga agjencitë e klasifikimit të kreditit në një mënyrë e cila është kuptimplotë për investitorët.

Për këtë numër punuan:

E. Shehi, R. Guri, V. Theodhori, A. Dervishi, F. Hebovija, J. Sokoli, R. Eltari, E. Zalta, E. Kokona